



REPUBLIKA E SHQIPERISE
AUTORITETI I KONKURRENCES

Njoftim për shtyp

Mbi

“Vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë për rrëzimin e kërkesë padisë së Vodafone Albania për shfuqizimin e vendimit 59 të Komisionit të Konkurrencës”

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka vendosur në seancën e datës 6 korrik 2009 të rrëzojë kërkesë padinë e shoqërisë Vodafone Albania për shfuqizimin tërësisht të Vendimit Nr. 59 datë 09. 11. 2007 të Komisionit të Konkurrencës “Për abuzim me pozitën dominuese në tregun e telefonisë së lëvizshme të shoqërive Albanian Mobile Communication SHA dhe Vodafone Albania SHA”, për pjesën që ka të bëjë me shoqërinë Vodafone Albania.

Sipas vendimit nr. 59 të datës 09.11.2007 të Komisionit të Konkurrencës, shoqëritë AMC sh.a dhe Vodafone Sh.A kanë abuzuar me pozitën dominuese duke vendosur çmime të padrejta në tregun e telefonisë së lëvizshme gjatë periudhës objekt-hetimi (2004, 2005).

Për shkeljen e konstatuar, shoqëritë AMC sh.a dhe Vodafone sh.a janë gjobitur me 2 për qind të xhiros vjetore të produktit përkatës të vitit 2005, që e shprehur në vlerë është respektivisht 211 552 000 lekë dhe 242 633 000 lekë.

Tekstin e plotë të Vendimit të Autoritetit të Konkurrencës “Për abuzim me pozitën dominuese në tregun e telefonisë së lëvizshme të shoqërive Albanian Mobile Communication sh.a. dhe Vodafone Albania sh.a.” mund ta gjeni në link-un e mëposhtëm:

<http://www.caa.gov.al/file/vendimet/Vendimi%2059%20AMC%20VOD.pdf>